



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-140

Prishtinë, më 30 dhjetor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 30 DHJETOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Sreten Ivanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 dhjetor 2013,
2. Përmbyllja e punimeve të Sesionit vjeshtor të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të mbajtur më 23 dhjetor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23 dhjetor 2013.

2. Përmbyllja e punimeve të Sesionit vjeshtor të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetari i Kuvendit e njoftoi Kryesinë e Kuvendit për gjithë aktivitetin gjatë vitit 2013, si në vijim: Kryesia e Kuvendit gjatë vitit 2013 i ka mbajtur 50 mbledhje me pjesëmarrjen edhe të kryetarëve të grupeve parlamentare, në të cilat janë përgatitur agjendat për rendin e ditës për 54 seanca plenare; e ka miratuar Projektbuxhetin e Kuvendit të Kosovës; i ka miratuar 182 vendime; i ka nxjerrë 77 përfundime, si dhe është marrë me organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, organeve të tij dhe Administratën e Kuvendit.

Kuvendi gjatë vitit 2013 ka mbajtur 54 seanca plenare, prej tyre 5 seanca solemne, 5 përkujtime dhe 3 të jashtëzakonshme, si dhe ka miratuar 61 ligje.

Komisionet parlamentare kanë mbajtur 405 mbledhje, në të cilat kanë shqyrtuar projektligje, raporte të agjencive të pavarura, si dhe kanë bërë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Organet e Kuvendit gjatë këtij viti kanë realizuar 36 vizita jashtë vendit dhe 64 vizita brenda vendit.

Kuvendi e ka realizuar buxhetin për vitin 2013 në masën 95,60%.

Në fund, kryetari tha se me këtë mbledhje Kuvendi i mbyll punimet e Sesioni vjeshtor për vitin 2013, ndërsa Sesioni pranveror fillon në javën e tretë të muajit janar të vitit 2014.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale